

Nr. 14 Prot.  
Dt. 23.10.1.2018

**Marrëveshja e bashkëpunimit**  
e datës 22. 01.2018 (Memorandum)

**PALE:**

- (1) Universiteti Europian i Tiranës sh.p.k., rregjistruar në Shqipëri më NIPT K62029010L, me seli në Bulevardi Gjergj Fishta Nr. 70, Tiranë, përfaqësuar nga z. Adrian Civici, (UET)
- (2) Infosoft Systems shpk, rregjistruar në Shqipëri më NIPT J618250021C me vendodhje Rr.Murat Toptani, Gjergji Center Tirane, përfaqësuar nga Z.Armand Shara ne cilesine e Administratorit te Pergjithshem
- (3) Infosoft Business Solutions shpk me NUIS L02214022G, me vendodhje Rr.Murat Toptani, Gjergji Center Tirane, përfaqësuar nga përfaqësuar nga Z.Armand Shara ne cilesine e Administratorit te Pergjithshem

Ketu e me poshte referuar si Infosoft Group.

**TE PERGJITHSHME**

- (A) Universiteti Europian i Tiranës është një institucion i arsimit të lartë (UET), i licensuar në përputhje me ligjin shqiptar me licencë nr. 639, datë 20.09.2006 dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- (B) INFOSOFT GROUP është një kompani profesionale me shumë eksperiencë, vecanërisht ne sektorin e sistemeve kompjuterike, softwareve, si dhe në fushën e import-eksportit, real-estate, etj.
- (C) Ky Memorandum vendos termat dhe kushtet kryesore të cilat shërbejnë për të dy palët për të ngritur bashkëpunimin me synimin e forcimit të lidhjes industri-universitet, në funksion dhe interes afatgjatë e strategjik të të dy palëve.
- (D) Ky Memorandum mbështetet në dëshirën e plotë të palëve për bashkëpunim, ai nuk është detyrues, nuk nënshkruhet para palëve të treta dhe humbet fuqinë e veprimit të tij me vullnetin e shprehur të secilës palë

**1. CESHTJET KRYESORE**

1.1 Ky Memorandum vendos parimet bazë përmes të cilave Universiteti Europian i Tiranës dhe INFOSOFT GROUP hyjnë në një bashkëpunim të dobishëm duke reflektuar dakordësinë për të ndërvepruar mes tyre në aftagjatë.

1.2 Gjatë kohës së veprimit të këtij Memorandumi, palët bien dakord të bashkëpunojnë mes tyre në lidhje me:

- A. INFOSOFT GROUP do të ofrojë mundësi për internship për studentët e UET-së (në funksion të nevojave të INFOSOFT GROUP dhe të degëve të studimit që ofron UET). Studentët mund të zhvillojnë internshipe me një shtrirje kohore nga 6 muaj deri në 2 vjet);
- I. Përzgjedhja e studentëve për internship do të bëhet në fazën e parë nga UET dhe më pas nga INFOSOFT GROUP në bashkëpunim me UET-në.
  - II. Për studentët që do të kryejnë internship në INFOSOFT GROUP, ai (INFOSOFT GROUP) do të vlerësojë në mënyrë periodike performancën e studentëve gjatë internshipit, në përputhje me një procedurë të hartuar nga UET dhe të dakordësuar mes palëve, duke ofruar në këtë mënyrë raporte specifike për UET-në, të cilat do të shërbejnë për evidentimin e ecurisë së studentëve, njohjen e krediteve të praktikës mësimore dhe mbajtjen e bazave të sakta të të dhënave.
  - III. Numri i studentëve që do të kryejnë internshipin në INFOSOFT GROUP, koha dhe fusha e specialitetit do të dakordësohet mes palëve në funksion të nevojave të INFOSOFT GROUP, aksesit në orare të përshtashme të studentëve, si dhe kufizimeve ligjore të cilat duhet të merren në cdo rast në konsideratë dhe dakordësuar mes palëve.
  - IV. UET merr përsipër të garantojë që studentët pjesëmarrës në internship do të ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe do të respektojnë rregullat, dhe procedurat e brendshme të INFOSOFT GROUP.
- B. Palët bien dakord për të vendosur një bashkëpunim në terma të organizimit të leksioneve të hapura, prezantimeve në ambjentet respektive, të vizitave në ambjentet e INFOSOFT GROUP nga studentët, të prezencës së stafit të INFOSOFT GROUP në evente, workshop-e, konferenca, etj të organizuara nga UET dhe që kanë interes për INFOSOFT GROUP.
- I. Universiteti do t'i bëjë të njohur, që në fillim të vitit akademik, kalendarin e eventeve që do të organizojë gjatë vitit, për të gjithë periudhën në të cilën ky Memorandum është në fuqi, me qëllim që INFOSOFT të përzgjedhë hapësirën e tij të interesit.
- C. Palët bien dakord për bashkëpunime që synojnë në:
- I. Përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, përshtatjen e silabuseve në pjesë të caktuara, vecanërisht në pjesën aplikative, hartimin e programeve të reja në nivelin bachelor dhe vecanërisht në master, ndryshimet e propozuara në cdo rast duhet të jenë në përputhje dhe respekt të ligjit të Arsimit të Lartë dhe rregulloreve të brendshme të UET-së.
  - II. Angazhimin e stafit të INFOSOT GROUP në pjesën aplikative të mësimdhënies, në seminare, laboratore dhe atelietë profesionale.

- III. Angazhimin e studentëve të masterit në punimin e temave të diplomës në fusha dhe çështje me interes për INFOSOFT GROUP. Temat e punimit do të shpallen nga INFOSOFT GROUP, do të miratohen me departamentet respektive dhe do të zgjidhen nga studentët duke u dakordësuar me mentorët. Angazhimi në këtë proces i dy mentorëve, një nga UET për anën teorike dhe të metodologjisë dhe mentori tjetër, nga INFOSOFT GROUP për pjesën empirike.
  - IV. Angazhimin e doktorandëve në punimeve doktorale në fusha dhe çështje me interes për INFOSOFT GROUP, por që konvergjojnë dhe me projektet kërkimore të miratuara në UET. Doktorandëve do t'u fasilitohet realizimi i pjesës empirike nga INFOSOFT GROUP.
  - V. Angazhimin e pedagogëve të UET-së në konsulenca dhe trajnime në funksion të nevojave të INFOSOFT GROUP, për këtë INFOSOFT GROUP do të konsiderojë UET me përparësi, në rastet kur i shtrihet nevoja për konsulenca dhe trajnime në fushat ku UET ka ekspertizë.
- D. Palët bien dakord të bashkëpunojnë në:
- I. Aplikimin për projekte europiane dhe ndërkombëtare, përmes zyrave të projekteve të secilës palë si dhe përmes angazhimit të partnerëve lokalë dhe ndërkombëtare të secilës palë,
  - II. Nënkontraktimin e INFOSOFT GROUP në projekte akademike dhe të kërkimit të cilat kërkojnë kompetencat dhe ekspertizën e INFOSOFT GROUP
  - III. Palët bien dakord, që gjatë gjithë kohës së veprimit të kësaj marrëveshje, t'i japin prioritet njëri-tjetrit në të gjitha projektet ndërkombëtare.
- E. Palët bien dakord të bashkëpunojnë mes tyre dhe në projekte të përgjegjësië sociale, duke rritur në këtë mënyrë impaktin në shoqërinë shqiptare e më gjerë. Për këtë:
- I. Palët dakordësojnë që zyrat/drejtoritë e marrëdhënive me publikun të paraqesin projektet vjetore, të diskutojnë mundësitë e bashkëpunimit, të lobimit dhe të përfshirjes dhe të të tretëve.

## 2. KOHEZGJATJA DHE PERFUNDIMI KONTRATES

- 2.1 Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e firmosjes nga të dy palët dhe vazhdon për një periudhë të paktën 1 vjecare, me të drejten e rishikimit në fund të mbylljes së cdo viti. Nëse palët nuk shprehen për mosvazhdimin e këtij memorandum atëherë ky Memorandum do të rinovohet në heshtje me të njëjtat kushte.
- 2.2 Palët mund ta zgjidhin këtë Memorandum edhe në mënyrë të njëanëshme, me anë të një njoftimi me shkrim ndaj palës tjetër në cdo kohë. Angazhimet që palët kanë marë

- përpar zgjidhjes së Memorandumit do të respektohen deri në fund sikur Memorandumi të mos ishte zgjidhur kurë
- 2.3 Çdo marrëveshje që do të arihet mes palëve në përputhje me këtë Memorandum dhe do të parashikoj kushte detyruese për palët do të rregullohet me një akt të posaçëm i cili duhe të nënshkruhet nga të dyja palët.
- 2.3. Palët bien dakord të përcaktojnë një person përgjegjës për të ndjekur gjithë bashkëpunimin mes palëve:
- a) Eralda Lameborshi  
[elameborshi@infosoftgroup.com.al](mailto:elameborshi@infosoftgroup.com.al)
- b) Prof.Asoc. Dr. Ermira Qosja  
E-mail: [ermira.qosja@uet.edu.al](mailto:ermira.qosja@uet.edu.al)
- 2.4 Gjithshka e shkruar në këtë Memorandum nuk synon ose nuk do të dëmtojë asnjë partnership tjetër të secilës palë.
- 2.5 Ky Memorandum, dhe gjithshka që rrjedh prej tij do të menaxhohet dhe ngrihet në përputhje me ligjin shqiptar, cdo mosmarrëveshje e cila nuk zgjidhet me mirëkuptim mes palëve do të zgjidhet në Gjykatën e Rrethit Tiranë

Për sa më lart, secila palë konfirmon dakordsinë me termat e këtij Memorandumi.

Universiteti Europian i Tiranës  
Prof.Dr. Adrian Civici



Infosoft Systems shpk  
Armand SHARA

Infosoft Business Solutions shpk  
Armand SHARA